



KONKURS Çmimi i Sportistit të vitit 2024

Në bazë të "Rregullores për dhënien e dekoratave" 01 Nr.27, datë: 31.03.2015 dhe plotësim-ndryshimin e kësaj rregullore, kërkohet nga klubet dhe shoqatat që të na i dërgojnë materialet e kompletuara për sukseset në fushën e sportit gjatë vitit 2024. Afati për dorëzimin e dokumenteve të kompletuara fillon nga 10.12.2024 deri më 31.12.2024.
Dokumentacioni dorëzohet në zyrën e udhëheqësit të sporteve në Ferizaj (salla "Bill Clinton").

PROPOZIMET PËR SPORTIST TË VITIT 2024

1. Sportisti/ja i/e vitit – Kategoria senior mbi 18 vjet	1
2. Sportisti/ja i/e vitit – Kategoria junior 15 - 18 vjet	1
3. Sportisti/ja i/e vitit – Kategoria kadet 11 – 14 vjet	1
4. Sportisti/ja i/e vitit - kategoria pioner 6 - 10 vjet.....	1
5. Ekipi i vitit (senior)	1
6. Trajneri i vitit.....	1
7. Gjyqtari i vitit	1
8. Pedagogu i vitit	3
9. Shoqata e vitit.....	1
10. Punëtori sportiv	1
11. Mjeku sportiv.....	1
12. Sportisti i vitit PAK	1

Në bazë të kriterëve për shpalljen e sportistit të vitit, Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, gjegjësisht Sektori i Sporteve nëpërmjet vendimit të Drejtorisë, ka formuar Këshillin e pavarur profesional që të vlerësojnë aplikacionet dhe të shpallin sportistin e vitit në bazë të të arriturve dhe rezultateve gjatë vitit 2024 të cilat i dërgojnë klubet sportive.

Në rast se verifikohet se klubet nuk japin informata të sakta do të eliminoj nga gara konkurentët. Klubet duhet ti dërgojnë propozimet, që të përshkruhen të arriturat dhe të dorëzohen në formë të kopjes, për ti mundësuar këshillit profesional të bëjnë përzgjedhjen e më të mirëve në mënyrë të drejtë. Propozimet të jenë zyrtare dhe të vulosura në mënyrë që mos të kemi propozime nga individët e ndryshëm.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas datës 31.12.2024, nuk do të pranohen.

Me respekt

DKRS-Ferizaj